KONVENTA

Ndërmjet

Republikës së Kosovës

dhe

Dukatës së Madhe të Luksemburgut

për eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimet në të hyra dhe në kapital dhe për parandalimin e evazionit dhe shmangies fiskale

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Dukata e Madhe e Luksemburgut

Me dëshirë të zhvillimit të mëtejmë të marrëdhënieve të tyre ekonomike dhe rritjes së bashkëpunimit në çështje tatimore,

Me qëllim të lidhjes së Marrëveshjes për eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimet në të hyra dhe në kapital pa krijuar mundësi për mos tatimim apo shmangie të tatimit përmes evazionit apo shmangies tatimore (përfshirë edhe përmes përpjekjeve për të lidhur traktate që kanë për qëllim të sigurojnë lehtësira të ofruara me këtë Marrëveshje për dobi indirekte të banorëve të shteteve të treta).

Pajtohen si në vijim:

Neni 1
PERSONAT E MBULUAR

1. Kjo Marrëveshje vlen për personat që janë banorë të njërit apo më shumë Shteteve Kontraktuese.

2. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, të hyrat që rrjedhin nga apo përmes një subjekti apo marrëveshjeje që trajtohet si pjesërisht apo tërësisht transparente nga aspekti fiskal sipas ligjeve tatimore të cilit do Shtet Kontraktues konsiderohen të jenë të hyra të një banori të një Shteti Kontraktues por vetëm nëse të hyrat konsiderohen si të hyra të banorit të atij Shteti për qëllim të tatimit nga Shteti.

Neni 2
TATIMET E PËRFSHIRA

1. Kjo Marrëveshje vlen për tatimet në të hyra dhe në kapital të shqiptuara në emër të një Shteti Kontraktues apo autoriteteve lokale të tij, pavarësisht mënyrës së mbledhjes së tyre.

2. Konsiderohen si tatime në të hyra dhe në kapital të gjitha tatimet e shqiptuara për të hyrat totale, apo kapitalin total, apo për elemente të të hyrave apo kapitalit, përfshirë tatimet në fitim nga tjetërsimi i pronës së tundshme apo të patundshme, tatimet në shumën totale të mëditjeve apo pagave që paguhen nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin kapital.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat vlen Marrëveshja janë në veçanti:

a) Në Republikën e Kosovës:
   (i) Tatimi në të hyrat personale; dhe
   (ii) Tatimit korporativ; (në tekstin e mëtejmë "tatimi i Kosovës").

b) Në Dukatën e Madhe të Luksemburgut:
   (i) Tatimi në të hyra për personat fizik (l'impot sur le revenu des personnes physiques);
   (ii) Tatimi korporativ (l'impot sur le revenu des collectivites);
   (iii) Tatimi në kapital (l'impot sur la fortune); dhe
   (iv) Tatimi tregtar komunal (l'impor commercial communal); në tekstin e mëtejmë "tatimi i Luksemburgut");

4. Marrëveshja vlen edhe për çfarëdo tatime të njëjta apo thelbësisht të ngjashme të cilat shqiptohen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes si shtesë, apo zëvendësim i tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese njoftojnë njëri tjetrin lidhur me çfarëdo ndryshimesh madhore që paraqiten në ligjet e tyre të tatimit.

Neni 3
PËRKUFIZIMET E PËRGJITHSHME

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, përveç nëse parashihet ndryshe nga konteksti:
a) Shprehja "Luksemburg" nënkupton Dukatën e Madhe të Luksemburgut dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Dukatës së Madhe të Luksemburgut;

b) Shprehja "Kosovë" nënkupton Republikën e Kosovës, përfshirë tërë territorin e saj tokësor, edhe ajrin sipër, mbi të cilat ushtron juridiksion apo të drejta sovrane për qëllime të hulumtimit, shfrytëzimit apo konzervimit të burimeve natyrore në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;
c) Shprehja "person" nënkupton individ, ndërmarrje apo çfarëdo trup tjetër personash;
d) Shprehja "kompani" nënkupton çfarëdo organi korporativ apo subjekt i cili trajtohet si organ korporativ për qëllime të tatimimit;
e) Shprehja "ndërmarrje" vlen për ushtrimin e çfarëdo veprimtarie afariste;
f) Shprehja "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkupton një sipërmarrje të kryer nga një banor i një Shteti Kontraktues dhe sipërmarrje e kryer nga një banor i shtetit tjetër Kontraktues;
g) Shprehja "komunikacioni ndërkombëtar" nënkupton çfarëdo transporti të kryer me anije, aeroplan apo automjet rrugor, i cili operohet nga një ndërmarrje e cila ka selinë e menaxhimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija, aeroplani apo mjeti rrugor operohen ekskluzivisht ndërmjet vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;
h) Shprehja "autoritet kompetent" nënkupton:
   (i) Në Luksemburg, Ministri i Financave apo përfaqësuesi i tij i autorizuar;
   (ii) Në Kosovë, Ministri i Financave apo përfaqësuesi i tij ose i saj i autorizuar;
i) Shprehja "shtetas", në raport me një Shtet Kontraktues, nënkupton:
   (i) Çfarëdo individi i cili posedon kombësinë apo shtetësinë e atij Shteti Kontraktues; dhe
   (ii) Çfarëdo personi juridik, partneritet apo asociacion i cili siguron statusin e tillë nga ligjet në fuqi në atë Shtet Kontraktues;
j) Shprehja "biznes" nënkupton kryerjen e shërbimeve profesionale dhe të veprimtarive të tjera të karakterit të pavarur.

2. Sa i përket aplikimit të Marrëveshjes në çfarëdo qofte kohe nga cili do Shtet Kontraktues, çfarëdo termi i padefinuar këtu, përveç nëse me kontekst parashihet ndryshe, ka kuptimin i cili i jepet në atë moment nga ligji i atij Shteti për qëllime të tatimit për të cilin vlen Marrëveshja, ku kuptimi i dhënë sipas ligjeve të tatimit në fuqi të atij Shteti janë më meritor në raport me kuptimin që i jepet shprehjes me ligjet tjera të atij Shteti.

Neni 4
Banor

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, shprehja "banor i një Shteti Kontraktues" nënkupton çfarëdo personi i cili, me ligjet e atij Shteti, i nënshtrohet tatimit atje në bazë të shtetësisë, vendbanimit, selisë së menaxhimit apo në bazë të çfarëdo kriteri tjetër të natyrës së ngjashme, dhe përfshin si Shtetin ashtu edhe pushtetin lokal të atij Shteti. Mirëpo, kjo shprehje nuk përfshin personat që iu nënshtrohen tatimeve në atë Shtet për të hyrat vetëm nga burimet e atij shteti apo nga kapitali që gjendet në atë Shtet.

2. Në rastet kur, për shkaqet e parapara me paragrafin 1, një individ është banor i të dyja Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij përcaktohet si në vijim:

a) Konsiderohet të jetë banor vetëm i Shtetit në të cilin ka një shtëpi të përhershme në dispozicion; në se ka shtëpi të përhershme në të dy Shtetet, konsiderohet të jetë banor vetëm i atij Shteti ku ka lidhje më të ngushta personale dhe familjare (qendra e interesave jetike);
b) Nëse nuk mund të përcaktohet Shteti me interesa jetike, apo nëse nuk ka shtëpi të përhershme në asnjërin Shtet, do të konsiderohet të jetë banor vetëm i atij Shteti ku ka një banim më të shpeshtë;

c) Nëse ka banim të shpeshtë në të dyja apo në asnjërin Shtet, do të konsiderohet të jetë banor vetëm i atij shteti në të cilin ka nënshtetësinë;
d) Nëse ka nënshtetësinë në të dyja apo në asnjërin shtet, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues zgjidhin çështjen me marrëveshje të ndërsjellë.3. Në rastet kur, bazuar në arsyet e parapara me paragrafin 1 një person, përveç personave fizik, është banor i të dyja Shteteve Kontraktuese, atëherë konsiderohet se është banor vetëm i Shtetit në të cilin gjenden selia e menaxhimit efektiv të subjektit.

Neni 5
SELIA E PËRHERSHME

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshje, shprehja "selia e përhershme" nënkupton vend fiks të afarizmit, përmes të cilit kryhet pjesërisht apo tërësisht veprimtaria afariste e një subjekti.

2. Shprehja "selia e përhershme" në veçanti përfshin:

a) Një vend të menaxhimit;
b) Një degë,
c) Një zyrë;
d) Një fabrikë;
e) Një punëtori, dhe
f) Një minierë, pus të naftës apo gazit, gurore apo ndonjë vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Shprehja "seli e përhershme" gjithashtu përfshin:
a) Kantier, vend-ndërtim, projekti montimi, instalimi apo gërryerje apo aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me to, por vetëm nëse zgjasin më shumë se 12 muaj;
b) Furnizimi i shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje përmes nëpunësve apo personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse vazhdojnë veprimtaritë e kësaj natyre (për të njëjtin projekt apo projekt të ndërlidhur) brenda Shtetit Kontraktues për një periudhë apo periudha të përbashkëta prej më shumë se 183 ditë në çfarëdo periudhe 12 mujore, e cila fillon apo përfundon në vitin fiskal të filluar.

4. Pavarësisht dispozitave të lartcekura të këtij neni, konsiderohet se shprehja "seli e përhershme" nuk përfshin:
a) Përdorimi i stabilimenteve vetëm për qëllime të magazinimit, ekspozimit apo liferimit të të mirave apo mallit që i takon një ndërmarrjeje;
b) Mirëmbajtja e stoqeve të të mirave apo mallit që i takon një ndërmarrjeje vetëm për qëllime të magazinimit, ekspozimit apo liferimit;
c) Mirëmbajtja e stoqeve të të mirave apo mallit që i takon një ndërmarrjeve vetëm për qëllime të përpunimit të ndërmarrjeve tjera;
d) Mirëmbajtja e një vendi fiks vetëm për qëllime të blerjes së të mirave apo mallit apo të mbledhjes së informatave, për ndërmarrjen;
e) Mirëmbajtja e një vendi fiks të afarizmit vetëm për qëllime të ushtrimit, për dobi të ndërmarrjes, të ndonjë veprimtarie e cila nuk është dhënë në nën-paragrafin a) deri d), me kusht që kjo veprimtari ka karakter përgatitor apo ndihmës; ose

f) Mirëmbajtja e një vendi fiks të afarizmit vetëm për çfarëdo kombinimi të veprimtarive të parapara në nën-paragrafin a) deri e), me kusht që veprimtaria e përgjithshme e vendit fiks të biznesit që rrjedh nga ky kombinim është e karakterit përgatitor apo ndihmës.

5. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2, ku një person – përveç ndonjë agjenti me status të pavarur për të cilin vlen paragrafi 6 – vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka ushtruar dhe rregullisht ushtron në një Shtet Kontraktues, kompetenca për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, kjo ndërmarrje konsiderohet si ka një seli të përhershme në atë Shtet në raport me çfarëdo veprimtarie të cilën personi i tillë ushtron për ndërmarrjen, përveç nëse veprimtaritë e personit të tillë kufizohen vetëm në ato të parapara me paragrafin 4 të cilat, nëse ushtrohen përmes një vendi fiks të afarizmit, nuk do ta bënin një vend të tillë fiks të afarizmit një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Konsiderohet se ndërmarrja nuk ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm sepse ushtron një veprimtari në atë Shtet përmes një agjenti, agjenti me provizion të përgjithshëm apo ndonjë përfaqësuesi tjetër me status të pavarur, me kusht që veprimtaria e tillë është e zakonshme për biznesin e tillë.

7. Fakti që ndërmarrja, e cila është banore e një Shteti Kontraktues, kontrollon apo është nën kontroll të një kompanie e cila është banore e Shtetit tjetër Kontraktues, apo e cila ushtron veprimtari në atë Shtet tjetër (qoftë përmes ndonjë selie të përhershme apo në forma të tjera), nuk krijon për një kompani vetvetiu seli të përhershme të kompanisë tjetër.

Neni 6
TË HYRAT NGA PATUNDSHMËRIA

1. Të hyrat e siguruara nga një banor i një Shteti Kontraktues nga patundshmëria (përfshirë nga bujqësia apo nga pylltaria), e cila gjendet në Shtetin tjetër Kontraktues mund t'i nënshtrohet tatimit në atë Shtet tjetër.

2. Shprehja "patundshmëri" ka kuptimin që i jepet me ligj të Shtetit Kontraktues ku gjendet prona në fjalë. Shprehja, në çdo rast, përfshin pronën mbështetëse në atë patundshmëri, bagëtinë apo pajisjet që përdoren në bujqësi dhe pylltari, të drejtat mbi të cilat vlejnë dispozitat e të drejtës së përgjithshme lidhur me patundshmërinë, të drejtat e shfrytëzimit (uzufrukti) i patundshmërisë dhe të drejtat në pagesa variabile apo fikse në shkëmbim të punës, të drejtës në punë, depozitave minerale, burime apo resurse të tjera natyrore; anije, barka dhe aeroplanë nuk konsiderohen si prona të patundshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 vlejnë për të hyra që rrjedhin nga shfrytëzimi i drejtpërdrejt, qiradhënia, apo përdorimi i patundshmërisë në çfarëdo qoftë forme.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 3 gjithashtu vlejnë për të hyrat nga patundshmëritë e ndërmarrjes.

Neni 7
PROFITET BIZNESORE

1. Profitet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues iu nënshtrohet tatimit vetëm në atë Shtet përveç nëse ndërmarrja ushtron afarizmin në Shtetin tjetër përmes një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja ushtron biznes në mënyrën e lartpërmendur, profitet e ndërmarrjes mund të tatohen në Shtetin tjetër por vetëm deri në masën sa mund realizohen nga ajo seli e përhershme.

2. Varësisht prej dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron veprimtarinë në Shtetin tjetër kontraktues përmes një selie të përhershme që gjendet në të, në secilin Shtet kontraktues kësaj ndërmarrjeje do t'i atribuohen profitet të cilat pritet t'i bëjë realizojë po të ishte një ndërmarrje e veçantë me veprimtari të njëjtë apo të ngjashme në kushtet të njëjta apo të ngjashme, dhe e cila vepron tërësisht pavarësisht me ndërmarrjen për të cilën vepron si seli e përhershme.

3. Gjatë përcaktimit të profiteve të një selie të përhershme, lejohet zbritja e shpenzimeve të cilat shkaktohen për selinë e përhershme, përfshirë edhe shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative, qoftë në Shtetin ku gjendet selia e përhershme apo gjetiu.

4. Sado që është e rëndomtë që në një Shtet Kontraktues të përcaktohen profitet që i atribuohen një selie të përhershme në bazë të ndarjes së profiteve totale në pjesë të ndryshme të saj, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton mundësinë që Shteti Kontraktues të përcaktojë profitet që tatohen me një ndarje të tillë të zakonshme; mirëpo, metoda e ndarjes duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet e parapara me këtë Nen.

5. Asnjë profit nuk i atribuohet ndonjë selie të përhershme për shkak të vetë blerjes së të mirave dhe mallrave për dobi të ndërmarrjes nga ajo seli e përhershme.

6. Për qëllime të paragrafëve paraprakë, profitet që i atribuohen një selie të përhershme përcaktohen nga metoda e njëjtë secilin vit, përveç nëse ka arsye e mirë që të veprohet ndryshe.

7. Në rastet kur në profite përfshihen zëre të të hyrave, të cilat shtjellohen ndarazi në Nenet tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk preken nga dispozitat e këtij Neni.

Neni 8
DËRGESAT, TRANSPORTI PËRMES RRUGËVE TË BRENDSHME UJORE DHE TRANSPORTI AJROR

1. Profitet nga veprimtaria e anijeve apo aeroplanëve në komunikacionin ndërkombëtar i nënshtrohet tatimit në Shtetin Kontraktues në vendin ku gjendet menaxhmenti efektiv i ndërmarrjes.

2. Profitet nga puna e barkave të angazhuara në transportin ujor brenda shtetit iu nënshtrohen tatimit vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin gjendet menaxhmenti efektiv i ndërmarrjes.

3. Nëse vendi i menaxhmentit efektiv të ndërmarrjes së dërgesave apo të një ndërmarrjeje ujore transportuese brenda vetes gjendet në bordin e një anije apo barke, atëherë konsiderohet se gjendet në Shtetin Kontraktues në të cilin gjendet limani vendor i anijes apo barkës, ose, nëse nuk ka një liman i tillë vendor, atëherë në Shtetin Kontraktues banor i të cilit është operatori i anijes apo barkës.

4. Dispozitat e paragrafit 1 vlejnë për profitet nga pjesëmarrja në ndonjë fond, biznes të përbashkët apo në agjenci ndërkombëtare operuese.

Neni 9
Ndërmarrjet e asociuara

1. Në rastet kur:
   a) Një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë, në mënyrë direkte apo indirekte, në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër kontraktues, ose
   b) Të njëjtët persona marrin pjesë, në mënyrë direkte apo indirekte, në menaxhimin, kontrolli ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe një ndërmarrjeje në Shtetin tjetër kontraktues,

   dhe në secilin rast krijohen apo imponohen kushtet ndërmjet dy ndërmarrjeve në raportet e tyre komerciale apo financiare, të cilat dallojnë nga ato të cilat do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çfarëdo profiti i cili do të realizohej nga cilado ndërmarrje, po të mos ekzistonin kushtet të tilla, dhe të cilat nuk janë realizuar për shkak të këtyre kushteve, mund të përfshihen në profite të asaj ndërmarrje dhe rrjedhimisht të tatohen.

2. Në rastet kur një Shtet Kontraktues përfshin në profite të një ndërmarrje të atij Shteti – dhe rrjedhimisht taton – profitet për të cilat një ndërmarrje e Shtetit tjetër kontraktues është ngarkuar me tatim në atë Shtet tjetër ndërsa profitet e tilla të përfshira janë profitet të cilat do të realizoheshin nga Shteti i parë i përmendur, nëse kushtet e krijuara ndërmjet dy ndërmarrjeve do të ishin si kushtet të cilat do të lidheshin ndërmjet dy ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ai Shtet tjetër rregullon në përputhje me këtë shumën e tatimit që i ngarkohet atyre profiteve në atë shtet. Në përcaktimin e këtij ndryshimi, merren parasysh dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe organet kompetente të Shteteve Kontraktuese konsultohen me njëri tjetrin sipas nevojës.

Neni 10
DIVIDENDËT

1. Dividendët që paguhen nga ndërmarrja e cila është banore e një Shteti kontraktues banori të një Shteti tjetër kontraktues mund të tatohen nga Shteti tjetër kontraktues.

2. Mirëpo, dividendët që paguhen nga ndërmarrja, ku kompania është banore e Shtetit kontraktues mund gjithashtu të tatohen në atë Shtet sipas ligjeve në fuqi të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është banor i Shtetit tjetër kontraktues, tatimi tillë nuk tejkalon:

   a) 0 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfitues (përveç nëse është partneritet), i cili drejtpërsëdrejti mban së paku 10 për qind të kapitalit të ndërmarrjes së paguan dividendët;
   b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet tjera.

3. Shprehja "dividendët" e përdorur në këtë nen nënkupton të hyra nga aksione, aksione "jouissance" (nga afarizmi i argëtimit) apo të drejta "jouissance", aksione nga mihja, aksione të themeluesit apo të drejta të tjera, të cilat nuk janë borxhe apo kërkesa, pjesëmarrja në profite, si dhe të hyrat nga të drejtat tjera korporatave, të cilat iu nënshtrohen trajtimit të njëjtë të tatimit si të hyrat nga aksione me ligjet e Shtetit tjetër, ku është banor ndërmarrja që bën shpërndarjen.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk vlejnë nëse pronari përfitues i dividendëve, i cili është banor i një Shteti kontraktues, ushtron veprimtarinë në Shtetin tjetër kontraktues ku është banor ndërmarrja që paguan dividendët, përmes një selie të përhershme të vendosur atje, dhe pasuria për të cilën paguhen dividendët është e ndërlidhur me selinë e tillë të përhershme. Në rastet e tilla, vlejnë dispozitat e Nenit 7.

5. Në rastet kur një kompani e cila është banore e një Shteti kontraktues nxjerr profite apo të hyra nga Shteti tjetër kontraktues, Shteti tjetër nuk mund të ngarkojë tatim në dividendët e paguara nga ndërmarrja, përveç nëse dividendët e tilla i paguhen banori të shtetit tjetër apo nëse pasuria për të cilën paguhen dividendët është e ndërlidhur me një seli të përhershme e cila gjendet në Shtetin tjetër, dhe as t'i ngarkojë me tatim profitet e pashpërndara të kompanisë, edhe nëse dividendat e paguara apo profitet e pa shpërndara përbëhen, tërësisht apo pjesërisht, nga profitet apo të hyrat që krijohen në një Shtet të tillë.

Neni 11
Interesi

1. Interesi që paraqitet në njërin Shtet kontraktues dhe i paguhet një banori në Shtetin tjetër kontraktues mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Mirëpo, interesi i tillë mund gjithashtu të tatohet në Shtetin kontraktues në të cilin paraqitet dhe sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është banori i Shtetit kontraktues, tatimi i tillë i ngarkuar nuk tejkalon 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Përkundër dispozitave të paragrafit 2, interesi që paraqitet në një Shtet kontraktues dhe i paguhen banorit të Shtetit tjetër i cili është pronar përfitues tatohet në atë Shtet tjetër vetëm nëse interesi i tillë paguhet

a) Për borxhet që dalin si pasojë e shitjes me kredi të ndonjë pajisjeje, mallit apo shërbimeve;
b) Për çfarëdo lloj kredi të lëshuar nga banka;
c) Për çfarëdo instrumenti të investimi kolektiv;
d) Për Shtetin tjetër apo për bankën qendrore apo autoritetin lokal nga ai shtet; ose
e) Për kreditë ndërmjet kompanive.

4. Shprehja "interes" e përdorur në këtë Nen nënkupton të hyrat nga borxhet – kërkesat të çfarëdo qoftë lloji, pavarësisht nëse është siguruar apo jo nga hipoteka dhe nëse ka të drejtë të merr pjesë apo jo në profitet e debitorit, dhe në veçanti, të hyrat nga letrat me vlerë të sigurisë dhe të hyrat nga obligacionet apo dëftesa të borxhit. Dënimet për pagesat e vonuara nuk konsiderohen si interes për qëllime të këtij Neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk vlejnë nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë banor i një Shteti Kontraktues, ushtron veprimtarinë në Shtetin Tjetër, në të cilin paraqitet interesi përmes një selie të përhershme e cila gjendet aty ndërsa borxhi-kërkesa për të cilin paguhet interesi është i ndërlidhur me selinë e tillë e tillë të përhershme. Në rastet e tilla, vlejnë dispozitat e Nenit 7.

6. Interesi konsiderohet se krijohet në Shtetin Kontraktues kur paguesi është banor i atij Shteti. Mirëpo, në rastet kur personi që paguan interes, pavarësisht nëse është banor i atij Shteti kontraktues apo jo, ka një seli të përhershme në një Shtet kontraktues për të borxhin e të cilit paguhet interesi i mbledhur,

dhe interesi i tillë bartet nga një seli e përhershme, atëherë interesi i tillë konsiderohet të jetë shkaktuar ë Shtetin ku gjendet selia e përhershme.

7. Në rastet kur, për shkak të ndonjë marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues apo ndërmjet atyre të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh borxhin-kërkesën për të cilën paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte dakorduar nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënie të tillë, dispozitat e këtij Neni vlejnë vetëm për shumën e përmendur në fund. Në rastet e tilla, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme në përputhje me ligjin e secilit shtet kontraktues, duke pasur parasysh edhe me dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12
TANTIEMAT

1. Tantiemat që paraqiten në një Shtet Kontraktues dhe janë në pronësi të një banori në Shtetin tjetër kontraktues i nënshtrohet tatimit vetëm në atë Shtet tjetër.

2. Shprehja "tantiemat", të përdorura në këtë Nen nënkupton pagesa të çfarëdo lloji nënkupton pagesat e çfarëdo lloji të pranuara për shfrytëzim, apo të drejtën për të shfrytëzuar, çfarëdo të drejtë autoriale të veprave letrare, artistike apo shkencore, përfshirë filmat kinematografik, çfarëdo patente, marke tregtare, dizajni apo modeli, plani, formule apo procesi sekret, apo për informatat e ndërlidhura me përvojën industriale, komerciale apo shkencore.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk vlejnë nëse pronari përfitues i tantiemave, nëse është banor i një Shteti Kontraktues, ushtron veprimtarinë në Shtetin tjetër kontraktues ku paraqitet tantiema, përmes një selie të përhershme që gjendet atje, dhe e drejta apo prona për të cilën paguhen tantiemat janë të ndërlidhura me selinë e përhershme. Në rastet e tilla, vlejnë dispozitat e Nenit 7.

4. Në rastet kur, për shkak të marrëdhënies së veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues apo ndërmjet atyre të dyve dhe personit të tretë, shuma e tantiemave për përdorim, të drejtën apo për informata për të cilat paguhen, e tejkalon shumën e cila do të ishte dakorduar ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij Neni vlejnë vetëm për shumën e përmendur në fund. Në rastin e tillë, pjesa e tepërt e pagesave iu nënshtrohet tatimit në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, në përputhje me dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
FITIMET KAPITALE

1. Fitimet e realizuara nga një banor i një Shteti kontraktues nga tjetërsimi i një prone të patundshme, të cekur me Nenin 6 dhe e cila gjendet në Shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pronës së lëvizshme, e cila është pjesë e prone afariste të një selie të përhershme, të cilat një Shtet kontraktues i ka në Shtetin tjetër kontraktues, përfshirë fitimet nga tjetërsimi i një selie të tillë të përhershme (vetë apo me tërë sipërmarrjen), mund të tatohet në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve apo aeroplanëve që operohen në komunikacionin ndërkombëtar, barkat e angazhuara në transportin ujor brenda shtetit apo prona e lëvizshme e ndërlidhur me operimin e

anijeve, aeroplanëve dhe barkave të tilla, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku gjendet menaxhmenti efektiv i ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çfarëdo prone, jashtë asaj të përmendur në paragrafët 1, 2 dhe 3, tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin është banor tjetërsuesi.

Neni 14
TË HYRAT NGA PUNËSIMI

1. Në përputhje me dispozitat e Nenit 15, 17 dhe 19, pagat, mëditjet dhe pagesat tjera që i realizon banori i një Shteti anëtar nga punësimi, tatohen në atë Shtet vetëm nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi realizohet në atë mënyrë, pagesat e realizuara në këtë mënyrë mund të tatohen në Shtetin tjetër.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, pagesat e realizuara nga një banor i një Shteti kontraktues për punësimin e ushtruar në Shtetin tjetër kontraktues tatohet vetëm në Shtetin e parë, nëse:

a) Pranuesi është i pranishëm në Shtetin tjetër për një periudhë apo periudha të cilat nuk tejkalojnë së bashku 183 ditë për periudhë 12 muajshe, e cila fillon apo përfundon në vitin kalendarik përkatës, dhe
b) Pagesa paguhet nga, apo në emër të, një punëdhënësi i cili nuk është banor i Shteti tjetër, dhe
c) Pagesa nuk bartet nga një seli e përhershme, të cilin punëdhënësi e ka në Shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të lartcekura të këtij Neni, pagesa e siguruara për punësimin e realizuar në bordin e ndonjë anije, aeroplani apo automjeti rrugor i cili operon në komunikacionin rrugor, apo në bordin e një anijeje të përfshirë në transportit ujor brenda shtetit, mund të tatohet në Shtetin kontraktues ku gjendet menaxhmenti efektiv i ndërmarrjes.

Neni 15
HONORARI I DREJTORËVE

Honorari i drejtorëve apo pagesat e tjera të ngjashme, që realizohen nga një banor i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një ndërmarrjeje, e cila është banore e Shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë Shtetin tjetër.

Neni 16
ARGËTUESIT DHE SPORTISTËT

1. Pavarësisht dispozitave të Nenit 14, të hyrat e siguruara nga një banor i një Shteti kontraktues si një argëtues, siç janë teatri, filmat, artist radioje apo televizioni, apo ndonjë muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të banorit, të cilat ushtrohen në Shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Në rastet kur të hyrat për veprimtaritë personale që ushtrohen nga një zbavitës apo sportist i cili ushtron veprimtari të tilla i dedikohen jo argëtuesit apo personit por ndonjë personi tjetër, të hyrat e tilla,

pavarësisht dispozitave të Nenit 14, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues, në të cilin realizohen veprimtaritë e tilla të argëtuesit apo sportistit.

Neni 17
PENSIONET

1. Në varësi prej dispozitave të paragrafit 2 të Nenit 18, pensionet dhe pagesat e tjera që i paguhen një banori të një Shteti Kontraktues për punësimin paraprak tatohet vetëm në atë Shtet.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, pensionet dhe pagesat tjera që bëhen sipas ligjeve të sigurimeve sociale të një Shteti kontraktues iu nënshtrohen tatimit vetëm në atë Shtet.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, pensionet dhe pagesat tjera të ngjashme (përfshirë pagesat paushall) që realizohen në një Shtet kontraktues dhe i paguhen banorit të Shtetit tjetër kontraktues, tatohen vetëm në Shtetin e parë të përmendur, me kusht që pagesat e tilla rrjedhin nga kontributet e paguara në apo nga dispozitat e skeme të tillë pensionale nga vetë pranuesi apo në emër të tij dhe se këto kontribute, kompensime apo pensione apo pagesa të tjera të ngjashme t'iu jenë nënshtruar tatimit në Shtetin e parë të përmendur në përputhje me rregullat e rëndomta të ligjeve të tyre të tatimit.

Neni 18
SHËRBIMI QEVERITAR

1. a) Pagat, mëditjet dhe pagesat tjera të ngjashme që paguhen nga një Shtet kontraktues apo nga ndonjë autoritet lokal i atij shteti për një individ në lidhje me shërbime që i ofrohen atij Shteti apo autoriteti iu nënshtrohen tatimit vetëm në atë Shtet.

b) Mirëpo, pagat, mëditjet dhe pagesat e tjera të ngjashme tatohen vetëm në Shtetin tjetër nëse shërbimet ofrohen në atë Shtet dhe individi është banor i atij Shteti, i cili:

(i) është shtetas i atij Shteti; ose
(ii) nuk është bërë banor i atij Shteti vetëm për qëllime të ofrimit të shërbimeve të tilla.

2. a) Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, pensionet dhe pagesat e tjera të ngjashme të paguara nga, ose nga fondet e krijuara nga Shteti kontraktues apo autoriteti lokal i atij Shteti për një individ në lidhje me shërbimet që i ofrohen atij Shteti apo autoriteti, tatohen vetëm në atë Shtet.
b) Mirëpo, pensionet dhe pagesat e tilla tatohen vetëm në Shtetin tjetër kontraktues nëse individi është banor apo shtetas i atij Shteti.

3. Dispozitat e Neneve 14, 15, 16 dhe 17 vlejnë vetëm për paga, mëditje, pensione dhe kompensime të tjera të ngjashme lidhur me shërbimet e ofruara për një veprimtari afariste që kryhen nga Shteti kontraktues apo nga autoriteti lokal i atij shteti.

Neni 19
STUDENTËT

Pagesat që i merr studenti apo praktikanti i biznesit i cili është bërë apo ka qenë banor i një Shteti Kontraktues tjetër mu para vizitës në Shtetin Kontraktues dhe i cili është i pranishëm në Shtetin e parë të përmendur vetëm për qëllim të shkollimit apo trajnimit dhe për qëllim të mirëmbajtjes së tij, shkollimit apo trajnimit nuk do të tatohen në atë Shtet, me kusht që pagesat të burojnë nga burime jashtë atij Shteti.

Neni 20
TË ARDHURAT E TJERA

1. Burimet e të ardhurave të banorit të Shtetit Kontraktues, ngado që të vijnë ato dhe që nuk janë trajtuar me nenet e mëparshme tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat e tjera kundruall të ardhurave nga prona e paluajtshme që janë përkufizuar në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i atyre të ardhurave, duke qenë banor i Shtetit Kontraktues, e vazhdon punën në Shtetin Kontraktues tjetër nëpërmjet një ndërmarrjeje që është themeluar në atë Shtet, ndërsa e drejta në pronë në lidhje me ato të ardhura paguhet në fakt në lidhje me një ndërmarrje të tillë. Në atë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

Neni 21
KAPITALI

1. Kapitali që përfaqësohet nga prona e paluajtshme që është përmendur në nenin 6, që është pronë e banorit të Shtetit Kontraktues dhe që gjendet në Shtetin Kontraktues tjetër, mund të tatohet në atë Shtet tjetër.
2. Kapitali që përfaqësohet nga prona e luajtshme që përbën pjesë të pronës së biznesit të një objekti të përhershëm që një ndërmarrje e ka në Shtetin Kontraktues tjetër mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

3. Kapitali që përfaqësohet nga anijet dhe aeroplanët që përdoren në trafikun ndërkombëtar dhe barkat që përdoren në rrugët e transportit ujor të brendshëm dhe nga prona e luajtshme që ndërlidhet me përdorimin e atyre anijeve, aeroplanëve dhe barkave tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet menaxhmenti efektiv i ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të banorit të Shtetit Kontraktues tatohen vetëm në atë Shtet.

Neni 22
ELIMINIMI I TATIMIT TË DYFISHTË

1. Duke iu nënshtruar dispozitave të ligjit të Luksemburgut përkitazi me eliminimin e tatimit të dyfishtë që nuk ndikojnë në parimin e përgjithshëm të tij, tatimi i dyfishtë eliminohet si vijon:

a) Kur banori ka burim të të ardhurave apo është pronar i kapitalit që, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje, mund të tatohet në Kosovë, Luksemburgu, duke iu nënshtruar dispozitave të nënparagrafëve b) dhe c), i liron ato të ardhura apo atë kapital nga tatimi, por mundet – për ta llogaritur shumën e tatimit mbi të ardhurat apo kapitalin e mbetur të banorit – t'i zbatojë tarifat e njëjta nëse ato të ardhura apo ai kapital nuk është i liruar nga tatimi.

b) Kur banori i Luksemburgut ka burim të të ardhurave që, sipas dispozitave të neneve 10, 11 dhe 16 mund të tatohet në Kosovë, Luksemburgu e lejon një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat personale apo nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave të atij banori në shumën e barabartë me tatimin që paguhet në Kosovë. Megjithatë, kjo zbritje nuk është më e madhe se pjesa e tatimit e cila, siç është llogaritur para zbatimit të zbritjes, mund t'i atribuohet burimeve të tilla të të ardhurave nga Kosova.

c) Dispozitat e nënparagrafit a) nuk zbatohen për burimet e të ardhurave apo kapitalit që është pronë e banorit të Luksemburgut kur Kosova i zbaton dispozitat e kësaj Marrëveshje për t'i liruar të ardhurat apo kapitalin e tillë nga tatimi apo kur i zbaton dispozitat e paragrafit 2 të nenit 10 ose nenit 11 për të ardhurat e tilla.

2. Në rastin e Kosovës, tatimi i dyfishtë evitohet si vijon:
a) Kur banori i Kosovës ka burim të të ardhurave që, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje, mund të tatohet në Luksemburg, Kosova e lejon, si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij banori, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat që paguhet në Luksemburg. Megjithatë, kjo zbritje nuk është më e madhe se pjesa e tatimit në Kosovë që, siç është llogaritur para zbatimit të zbritjes, i atribuohet, siç mund të ndodhë, të ardhurave që mund të tatohen në Luksemburg.

b) Kur, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshje, të ardhurat e banorit të Kosovë janë të liruara nga tatimi në Kosovë, Kosova, megjithatë, kur e llogarit shumën e tatimit të të ardhurave të mbetura të atij banori, mund t'i marrë parasysh të ardhurat e liruara nga tatimi.

Neni 23
MOSDISKRIMINIMI

1. Shtetasit e Shtetit Kontraktues nuk i nënshtrohen në Shtetin Kontraktues tjetër ndonjë tatimi apo kushti që ndërlidhet me të e që është tjetër apo më i rëndë se tatimi dhe kushtet që ndërlidhen me të e të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij Shteti tjetër në rrethanat e njëjta, në veçanti sa i përket vendbanimit. Kjo dispozitë zbatohet, pa i marrë parasysh dispozitat e nenit 1, edhe për personat që nuk janë banorë të njërit apo të të dyja Shteteve Kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi që janë banorë të Shtetit Kontraktues nuk i nënshtrohen në asnjërin Shtet Kontraktues ndonjë tatimi apo kushti që ndërlidhet me të, e që është tjetër apo më i rëndë se tatimi dhe kushtet që ndërlidhem me të e të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij Shteti tjetër në rrethanat e njëjta, në veçanti sa i përket vendbanimit.

3. Tatimi mbi objektin permanent që ndërmarrja e një Shteti Kontraktues e ka në Shtetin Kontraktues tjetër nuk do të jetë më i lehtë se tatimi që zbatohet për objektet e atij Shteti tjetër ku kryhen aktivitetet e njëjta. Kjo dispozitë nuk interpretohet si dispozitë që e obligon Shtetin Kontraktues që t'u ofrojë banorëve të Shtetit Kontraktues tjetër ndonjë mëditje, ndihmë apo zbritje për qëllime të tatimit për shkak të statusit civil apo përgjegjësive familjare që ua garanton banorëve të vet.

4. Përveç kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11 apo paragrafit 4 të nenit 12, kamata, tantiemat dhe pagesat e tjera që ndërmarrja e Shtetit Kontraktues ia bën banorit të Shtetit Kontraktues tjetër, me qëllim të përcaktimit të profiteve të tatueshme të asaj ndërmarrjeje, lirohen nga tatimi sipas kushteve të njëjta sikur t'i ishin bërë banorit të Shtetit të parë të përmendur. Ngjashëm, çdo borxh që ndërmarrja e Shtetit Kontraktues ia ka banorit të Shtetit Kontraktues tjetër, me qëllim të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të asaj ndërmarrjeje, zbritet sipas kushteve të njëjta sikur t'i ishin kontraktuar banorit të Shtetit të parë të përmendur.

5. Ndërmarrjet e Shtetit Kontraktues kapitali i të cilave kontrollohet tërësisht apo pjesërisht, në mënyrë direkte apo indirekte, nga një apo më shumë banorë të Shtetit Kontraktues tjetër nuk i nënshtrohen në Shtetin e parë të përmendur ndonjë tatimi apo kushti që ndërlidhet me të e që është më i rëndë se tatimi apo kushtet që ndërlidhen me të e të cilave u nënshtrohen apo mund t'u nënshtrohen ndërmarrjet e ngjashme të Shtetit të parë të përmendur.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen, pa i marrë parasysh dispozitat e nenit 2, për tatimin e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 24
PROCEDURA E MARRËVESHJES SË NDËRSJELLË

1. Kur një person konsideron se veprimet e njërit apo të dyja Shteteve Kontraktuese rezultojnë apo mund të rezultojnë në tatim për të që bie ndesh me dispozitat e kësaj Marrëveshje, ai ka të drejtë që, pa i marrë parasysh mjetet juridike që përcaktohen me ligjet vendore të atyre Shteteve, rastin e tij t'ia paraqesë organit kompetent të cilitdo Shtet Kontraktues. Rasti mund të paraqitet brenda tri viteve nga njoftimi i parë për veprimin që ka rezultuar në tatim që bie ndesh me dispozitat e kësaj Marrëveshje.

2. Organi kompetent përpiqet – nëse kundërshtimi i duket i arsyetuar dhe nëse vetë nuk është në gjendje ta arrijë një zgjidhje të kënaqshme – që ta zgjidhë rastin me marrëveshje të ndërsjellë me organin kompetent të Shtetit Kontraktues tjetër, me qëllim të evitimit të tatimit që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pa i marrë parasysh kufizimet kohore të parapara me ligjet vendore të Shteteve Kontraktuese.

3. Organet kompetente të Shteteve Kontraktuese përpiqen që ta zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që paraqitet e që ka të bëjë me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshje me marrëveshje të ndërsjellë. Ato po ashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk janë përcaktuar me këtë Marrëveshje.

4. Organet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëra tjetrën drejtpërsëdrejti, përfshirë përmes ndonjë komisioni të përbashkët që përbëhet nga to apo nga përfaqësuesit e tyre, me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve pararendës.

5. Kur,

a) sipas paragrafit 1, një person ia ka paraqitur rastin organit kompetent të Shtetit Kontraktues duke u bazuar në veprimet e njërit apo të dyja Shteteve Kontraktuese që për të kanë rezultuar në tatim që bie ndesh me dispozitat e kësaj Marrëveshje, dhe

b) organet kompetente nuk janë në gjendje të arrijnë marrëveshje për ta zgjidhur rastin sipas paragrafit 2 brenda dy viteve nga data kur të gjitha informatat që kërkohen nga organet kompetente për ta shqyrtuar rastin u janë siguruar të dyja organeve kompetente, çdo çështje e pazgjidhur dhe e ngritur në atë rast dorëzohet për arbitrazh, nëse personi kërkon ashtu. Megjithatë, këto çështje të pazgjidhura nuk dorëzohen për arbitrazh nëse ndonjë gjykatë apo tribunal administrativ i cilitdo shtet tashmë ka marrë vendim për to. Përveç nëse personi që është ndikuar drejtpërsëdrejti nga rasti nuk e pranon marrëveshjen e ndërsjellë që e zbaton vendimin e arbitrazhit, vendimi është i detyrueshëm për të dyja Shtetet Kontraktuese dhe zbatohet pa i marrë parasysh kufizimet kohore të parapara me ligjet vendore të këtyre Shteteve. Organet kompetente të Shteteve Kontraktuese e caktojnë mënyrën e zbatimit të këtij paragrafi me marrëveshje të ndërsjellë.

Neni 25
SHKËMBIMI I INFORMATAVE

1. Organet kompetente të Shteteve Kontraktuese i shkëmbejnë informatat që parashihen si relevante për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje apo për administrimin apo zbatimin e ligjeve vendore që kanë të bëjnë me tatimet e çdo lloji apo përshkrimi dhe që zbatohen në emër të Shteteve Kontraktuese apo të organeve vendore të tyre për aq sa tatimi sipas tyre nuk është në kundërshti me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informatave nuk kufizohet me nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informatë që merret sipas paragrafit 1 nga Shteti Kontraktues trajtohet si sekrete në të njëjtën mënyrë si informatat që merren sipas ligjeve vendore të atij Shteti dhe u zbulohet vetëm personave dhe organeve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) relevante për vlerësimin dhe mbledhjen, zbatimin apo ndjekjen si dhe vendosjen për ankesat që kanë të bëjnë me tatimet që janë përmendur në paragrafin 1 apo për mbikëqyrjen e procedurave të lartpërmendura. Personat apo organet e tilla i përdorin këto informata vetëm për këto qëllime. Ato kanë të drejtë që këto informata t'i zbulojnë në procedurë gjyqësore apo vendime gjyqësore. Pavarësisht asaj që u tha më lart, informatat që i merr Shteti Kontraktues mund të përdoren për qëllime të tjera kur ato informata mund të përdoren për qëllime të tilla sipas ligjeve të të dyja Shteteve dhe kur organi kompetent i Shtetit dhënës e autorizon përdorimin e tillë.

3. Nëse asnjë rast dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk mund të interpretohen si dispozita që Shtetit Kontraktues ia imponojnë obligimin:
a) për të zbatuar masa administrative që ndryshojnë nga ligjet dhe praktika administrative e tij apo Shtetit Kontraktues tjetër;
b) për të dhënë informata që nuk mund të merren sipas ligjeve apo në vazhdën normale të administratës së tij apo Shtetit Kontraktues tjetër;
c) për të dhënë informata që do ta zbulonin ndonjë sekret tregtar, afarist, industrial, komercial apo profesional apo ndonjë proces tregtar apo informata zbulimi i të cilave do të binte ndesh me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informatat kërkohen nga Shteti Kontraktues në përputhje me këtë nen, Shteti Kontraktues tjetër i përdor masat e tij për mbledhjen e informatave për t'i marrë informatat e kërkuara, edhe nëse Shtetit tjetër mund të mos i duhen informatat e tilla për qëllimet e veta për tatim. Obligimi që e përmban fjalia pararendëse u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast ato kufizime nuk duhet të interpretohen si kufizime që ia lejojnë Shtetit Kontraktues që të refuzojë t'i japë informatat vetëm pse nuk ka interes të brendshëm për ato informata.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 nuk interpretohen si dispozita që ia lejojnë Shtetit Kontraktues që të refuzojë të japë informata vetëm pse ato informata mbahen nga ndonjë bankë apo institucion financiar, i emëruar apo person që vepron në ndonjë agjenci apo cilësi mirëbesimi apo pse ato ndërlidhen me interesat e pronësisë së ndonjë personi.

Neni 26
PJESËTARËT E MISIONEVE DIPLOMATIKE DHE POSTET KONSULLORE

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndikon në privilegjet fiskale të pjesëtarëve të misioneve diplomatike apo posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Neni 27
E DREJTA NË BENIFICIONE

1. Pa i marrë parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshje, benificion sipas kësaj Marrëveshje nuk jepet në lidhje me ndonjë burim të të ardhurave apo kapital nëse është e arsyeshme të përfundohet, duke i marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante, se marrja e atij benificioni ka qenë njëri ndër qëllimet kryesore të çfarëdo marrëveshjeje apo transaksioni që ka rezultuar drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte në atë benificion, përveç nëse përcaktohet se dhënia e atij benificioni në këto rrethana do të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave relevante të kësaj Marrëveshje.
2. Kur një benificion sipas kësaj Marrëveshje i mohohet një personi sipas paragrafit 1, organi kompetent i Shtetit Kontraktues që përndryshe do ta kishte dhënë këtë benificion megjithatë duhet ta trajtojë atë person si person që ka të drejtë në atë benificion apo në benificione të ndryshme që kanë të bëjnë me një burim specifik të të ardhurave dhe, sipas kërkesës nga ai person dhe pas shqyrtimit të fakteve dhe rrethanave relevante, të

përcaktojë nëse benificionet e tilla do t'i ishin dhënë atij personi në mungesë të transaksionit apo aranzhimit të përmendur në paragrafin 1. Organi kompetent i Shtetit Kontraktues të cilit i është bërë kërkesa do të konsultohet me organin kompetent të Shtetit tjetër para se ta refuzojë kërkesën e bërë sipas këtij paragrafi nga banori i atij Shteti tjetër.

Neni 28

HYRJA NË FUQI

1. Shtetet Kontraktuese e njoftojnë njëra tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se procedurat që kërkohen me ligjet e tyre për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje janë plotësuar. Kjo Marrëveshjeë hyn në fuqi më datën e pranimit të njoftimit të fundit.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, të ardhurat e krijuara më apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin hyn në fuqi kjo Marrëveshje;

b) në lidhje me tatimet e tjera, përfshirë tatimet mbi kapitalin si dhe tatimet që mund të vihen për çdo vit të tatueshëm që fillon më apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin hyn në fuqi kjo Marrëveshje.

Neni 29

SHFUQIZIMI

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi derisa të anulohet nga Shteti Kontraktues. Cilido Shtet Kontraktues mund ta shfuqizojë këtë Marrëveshje, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftim për anulimin e saj së paku gjashtë muaj para fundit të vitit kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes së saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet më:

a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim dhe të ardhurat e krijuara më apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi;

b) në lidhje me tatimet e tjera mbi të ardhurat, përfshirë tatimet mbi kapitalin, si dhe tatimet që mund të vihen për çdo vit të tatueshëm që fillon më apo pas 1 janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë njoftimi.

Duke qenë vetë dëshmitarë dhe të autorizuar, këtë Marrëveshje e kanë nënshkruar personat e poshtëshënuar.

Përpiluar në dublikatë në Luksemburg, më 8 dhjetor të vitit 2017, në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Bedri Hamza

Ministër i Financave

Për Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Pierre GRAMEGNA

Ministër i Financave

PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje midis Republikës së Kosovës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe parandalimin e evazionit dhe shmangies së tatimit, të dyja palët kanë rënë dakord për dispozitat në vijim, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje:

1. Sa i përket nenit 4:

1. Mjeti i investimit kolektiv që është themeluar në Shtetin Kontraktues dhe që trajtohet si korporatë për qëllime të tatimit në këtë Shtet Kontraktues konsiderohet si banor i Shtetit Kontraktues në të cilin është themeluar dhe si pronar përfitues i të ardhurave që i merr.

2. Mjeti i investimit kolektiv që është themeluar në Shtetin Kontraktues dhe që nuk trajtohet si korporatë për qëllime të tatimit në këtë Shtet Kontraktues konsiderohet si individ që është banor i Shtetit Kontraktues në të cilin është themeluar dhe si pronar përfitues i të ardhurave që i merr.

2. Sa i përket paragrafit 3 të nenit 5:

Kuptohet se një vendndërtim, ndërtim, vendmontim, instalim apo projekt i gërmimit apo ndonjë aktivitet mbikëqyrës në lidhje me të sipas nënparagrafit a) nuk mund të përbëjë objekt permanent sipas paragrafit b).

Duke qenë vetë dëshmitarë dhe të autorizuar, këtë Marrëveshje e kanë nënshkruar personat e poshtëshënuar.

Përpiluar në dublikatë në Luksemburg, më 8 dhjetor të vitit 2017, në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Bedri Hamza

Ministër i Financave

Për Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Pierre GRAMEGNA

Ministër i Financave